



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 532 Akti

Nr. 383 Vendimi
Tiranë, më 11.5.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Etleđa Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonđa Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. **Gerrit Sprenger**, në datën 11.5.2021, mori në shqyrtim çështjen që i përket,

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Durim Kadiu**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Aneksi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 842016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Suela Zhegu, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Durim Kadiu, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë deri në datën 4.5.2021, datë në të cilën ka ndërruar jetë.
2. Me vendimin nr. 1, datë 15.6.2020, trupi gjykues shprehu mospasjen e konfliktit të interesit, si dhe caktoi kryesuese komisioneren Etleda Çiftja.
3. Në datën 30.6.2020, subjektit të rivlerësimit iu dërguar përbërja e trupit gjykues, si dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit. Në datën 6.10.2020, iu dërgua pyetëtori standard. Subjekti ka deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues, si dhe ka depozituar përgjigjet e pyetësorit standard.
5. Komisioni mori dijeni nga burime mediatike se subjekti i rivlerësimit, z. Durim Kadiu, ka ndërruar jetë. Në këto kushte, Komisioni iu drejtua me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2021, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për të na vënë në dizpozicion certifikatën e vdekjes për të ndjerin Durim Kadiu.
6. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, informon se z. Durim Kadiu ka ndërruar jetë në datën 4.5.2021, duke bashkëlidhur edhe certifikatën e vdekjes.

ARSYETIMI I KOMISIONIT

7. Subjekti i rivlerësimit, z. Durim Kadiu, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligjit, ka dërguar dhe plotësuar, si vijon:
 - a. plotësimi dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b. plotësimi dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c. plotësimi dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.
9. Komisioni, pas fillimit të procedurës së rivlerësimit, në kushtet kur subjekti ka ndërruar jetë, çmon se duhet të përfundojë këtë procedurë pa një vendim përfundimtar në bazë dhe për zbatim:
 - të nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sipas kësaj dispozite: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen*”, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij kodi;

- të nenit 93 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se: “Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar, në nenet 90 dhe 93 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 64 të ligjit nr. 94/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Durim Kadiu.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 11.5.2021.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Etleda ÇIFTJA

Kryesuese

Alma FASKAJ

Anëtare

Suela ZHEGU

Relatore

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha